



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 20701 Prot.

6

Patos më 22.07.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 18.07.2025

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 në orën 11:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Armand Ahmetaj
2. Klaudio Alisininaj
3. Erald Çepele
4. Ertila Myrtaj
5. Smerald Haziazaj
6. Artan Velcani
7. Elmira Rama
8. Novrus Toska
9. Vjollca Kasaj
10. Renaldo Shpata
11. Lori Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar qytetar!

Të nderuar anëtar të këshillit bashkiak!

Të nderuar përfaqësues të administratës së bashkisë.

Jemi në mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak.

Pjesëmarrja ligjore është 11 këshilltarë. Kuorumi është ligjor dhe në rregull.

Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.06.2025.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.06.2025.

4-Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2025".

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2025".

6- Projekt-vendim "Mbi miratimin e tavaneve përfundimtar të Programit Buxhetor 2026-2028".

7- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjes së jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz".

8- Projekt-vendim "Për një ndryshim në vendimin nr. 82, datë 27.11.2024 " Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025".

9- Shqyrtimi i kërkesës nr. 1918 prot., datë 23.06.2025 për dhënie ndihmë financiare.

Kuorumi i mbledhjes kalon në 12 pjesëmarrja me ardhjen e këshilltares Albiona Lamaj.

Nëse s'keni ndonjë kërkesë për të hequr ose për të shtuar në rendin e ditës mund të kalojnë në votimin e rendit të ditës.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet me 12 vota pro abstenim ska, kundër ska.


SEKRETARE

Refaela Xeba




KRYETAR

Armand Ahmetaj



Lori Musaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2070 Prot.
7

Patos më 22.07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.06.2025.

Armand Ahmetaj – Nëse keni ndonje vërejtje ose konstatim në lidhje me procesverbalin i cili është hartuar në zbatim të të gjithë rregullave dhe ligjit në fuqi ?

Atëherë nuk kemi gjë tjetër, ezaurohet pika 2 .

SEKRETARE
Refaela Xeba

RX

Renaldo Shpota

Lori Musaj
Artan Velasari

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2079/18 Prot.

Patos më, 22.07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.06.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 30.06.2025 u morën gjithsej 9 vendime nga nr. 29 deri në 37 .

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vetëm vendimi me nr. 31 dhe 33 i është përcjell Prefekturës për verifikim të ligjshmërisë dhe na ka ardhur përgjigja në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj

ARTAN VELÇANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2128 / 3 Prot.

Patos më 22 07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2025”.

Armand Ahmetaj- Dua t’ju informoj se kjo pikë ka kaluar në komisionin e Ekonomisë i cili do të shprehet pasi të prezantohet nga ekzekutivi.
Ekzekutivi relaton!

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social-
Projekt-vendim nr. 36 datë 11.07.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2025”.

Ekzekutivi i propozon Këshillit të Bashkisë Patos të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin qershor 2025 gjithsej 17 familje me një fond prej 75,498 lekë. Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë– përshëndetje të gjithëve komisioni ekonomisë u mblodh ditën e martë në datë 15 korrik dhe ka diskutuar mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe ne kemi vendosur të miratojmë pa asnjë ndryshim duke votuar me pesë vota pro.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj - propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2025”.

Kush është dakord?

Miratohet me 12 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Armand Ahmetaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 21291 Prot.
13

Patos më 22 07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2025”.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social-

Projektvendim nr. 37 datë 11.07.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2025”.

Ekzekutivi i propozon Këshillit të Bashkisë Patos të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin qershor 2025 gjithsej 18 familje me një fond prej 68,880 lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë– Në mbledhjes së komisionit është diskutuar dhe mbi këtë projektvendim ku është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojmë me pesë vota pro,

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 12 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Lori Musaj
ARTAN VELÇAKI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2131/3 Prot.

Patos më 22.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projektvendim “Mbi miratimin e tavanëve përfundimtar të Programit Buxhetor 2026-2028”.
Armand Ahmetaj- ekzekutivi relaton dhe më pas komisioni për opinionin!

Mimoza Shtëmbari – Drejtore Financës -ky projektvendim vjen si vazhdimi fazave të përgatitjes së buxhetit afatmesëm dhe ka të bëjë më miratimin e Tavanëve përfundimtar të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028.

Në këtë fazë tavanet ardhurave dhe shpenzimeve nuk kanë ndryshuar përpos faktit të ndryshimeve të vogla të lëvizjeve brenda programeve të përshtatura me sistemin e menaxhimit financiar me Ministrinë e Financave ,

Në këtë projektvendim janë të pasqyruara shpenzimet dhe të ardhurat e miratuara të dokumenti i pari buxheti afatmesëm dhe ka ndryshim është bashkuar policia bashkiake të cilat është trajtuar në atë dokument si program më vete me sigurinë vendore dhe janë bërë ndryshime brenda përbrenda tavanëve midis llogarisë 602 dhe 231 duke bërë financimet e brendshme të zërave buxhetorë dhe vazhdon me të njëjtën numër programesh pasi ne jemi një bashki pilot e përzgjedhur si viti i pari buxhetimit në këtë fazë bashki pilot me gjashtë programe

Të tjerat janë të pandryshuara nga dokumenti i parë i miratuar në qershor nga këshilli bashkiak.

Erald Çepele- tek pjesa e sigurisë publike kemi një rritje me 5.4 milion për çfarë është parashikuar kjo? Një shpjegim pak më detajuar në lidhje me këtë pjesë.

Mimoza Shtëmbari- policia bashkiake ishte pjesë e administratës është hequr dhe është shtuar tek siguria publike dhe vjen rritje e këtij programi të siguria publike vetëm nga policia bashkiake brenda të njëjtit brenda të njëjtit burim, burimet nuk ndryshojnë dhe shpenzimet në total si dokumenti i parë janë po të njëjta, shpenzime dhe të ardhurat janë po të njëjtat për 2026 - 684 milion për 2027 - 691 milion dhe për 2028 - 697 milion të barabarta me dokumentin e parë të miratuar në qershor pa ndryshime.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë – Në mbledhjen e datës 15 është diskutuar dhe ky projektvendim të cilin e kemi argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur të miratojmë pas një ndryshim me katër vota pro.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj – Propozoj të kalojmë në votim e pikës gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, faza e parë 2026-2028”.

Kush është dakord?

Miratohet me 12 vota pro, ska kundër , abstenim ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 594/Prot.
14

Patos më 22.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjes së jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz”.

Armand Ahmetaj- Edhe kjo çështje ka kaluar në komisionin përkastës i cili do të paraqesë opinionin e vet pas prezantimit që do të bëhet nga administrata.

Arben Shpërdheja -Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjes së jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz”.

Nisur nga kërkesa e përsëritur, me nr. 594 prot., dt. 26.02.2025 dhe e këshilltarit z. Erald Çepele për z. Alburant Serdari ku në kërkesë shprehet për ndihmë financiare, pasi si pasojë e zjarrit të rënë në banesë babai i tij ka ndërruar jetë. Kjo e vërtetuar me skedën e vdekjes dt. 27.04.2022. Z. Alburant Serdari ka paraqitur kërkesën me nr. 1155 prot., datë 10.05.2022, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë dhe për ndihmë për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr. 80, datë 06.05.2022. Komisioni ka shkuar në terren dhe ka mbajtur procesverbal më datë 10.05.2022, mbi dëmet e shkaktuara nga kjo fatkeqësi. Në bazë të pikës 2 dhe shkronjës a) të pikës 3 të kapitullit III të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” i ndryshuar, përcaktohet “Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare”: a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes; b) Vendim i këshillit të komunës ose i bashkisë: Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmet në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake; Çertifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë; Çertifikata e vdekjes së pjestarit të familjes, kur ka raste të tilla, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjeko-ligjor, sipas rastit; Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në raste eksplozivi; Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara nëse është rrëshqitje toke; Konfirmimi i vendimit të njësisë së qeverisjes vendore për bazueshmërinë ligjore nga ana e institucionit të Prefektit të qarkut; Shkresa nga njësitë e qeverisjes vendore dhe këshilli i qarkut, ku të shprehet masa e ndihmës së dhënë për familjen e dëmtuar, në rast se ka, ose pamundësia financiare për ta ndihmuar, për mungesë fondesh.

Pika 3. Përcaktimi i ndihmës financiare. Masa e ndihmës financiare që Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme akordon në rastin e humbjes së jetës së anëtarëve të familjes, si pasojë e fatkeqësisë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për çdo person të vdekur.

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, i ndryshuar, V.K.M-së nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3.1 shkronja a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 41, “E drejta e kompesimit”, pika 2) dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile, për këto arsye i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Të miratojë masën e ndihmës financiare prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë në rastin e humbjes së jetës të anëtarëve të familjes.

Vlera e kësaj ndihme do të mbulohet nga “Fondi i mbrojtjes civile” nga të ardhurat vendore.

Lori Musaj - Në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar mbi këtë projektvendim të cilin nuk e kemi diskutuar për herë të parë dhe patjetër që komisioni ka shprehur dakordësinë e tij për ta miratuar pas një ndryshim këtë projektvendim.

Ne e kemi votuar me katër vota pro, projektvendimi është në përputhje me bazën ligjore dhe ndaj ftoj kolegët këshilltarë ta miratojnë.

Faleminderit!

Albiona Lamaj - Unë doja thjesht të përgëzoja anëtarin e këshillit rreth kërkesës së bërë dhe kjo është një temë ose është një ne e kemi kaluar dhe herë tjetër në mbledhjen këshillit dhe duhet thënë që këshilli e ka votuar unanimisht pozitiv për të dhënë ndihmën ekonomike dhe këtë herë anëtarit të riktheu përsëri dhe mesa duket u gjet mundësia tani që të jetë në përputhje me ligjin dhe mos të këtë përsëri kthim nga Prefektura mbrapsht që kjo familje të marrë ndihmën e nevojshme që duhet ta kishte marrë me kohë.

Armand Ahmetaj – Kalojmë në votim e pikës shtatë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjes së jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 12 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 21327 Prot.
13

Patos më 22.07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 82, datë 27.11.2024 “ Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”.

Ekzekutivi relaton materailin. Endri Adushaj- Përshendetje Projekt-vendim nr, 40 datë 11.07.2025 “Për një ndryshim në vendimin nr. 82, datë 27.11.2024 “ Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”.

Bazuar në pikën ‘f’ të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, dat 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

Të miratoj ndryshimin në pikën 27 “Tarifa të tjera për shërbime administrative” në zërin Tarifë shërbimi për fëmijë kopësht çerdhe 200 lekë në vendimin nr. 82, datë 27.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025” të bëhet “Dhënie shërbim për fëmijë, kopësht, çerdhe falas”.

Për ta sqaruar ky është një korrigjim në paketën fiskale të vitit 2025 e cila është miratuar me vendim të këshillit bashkiak nr. 82, datë 27.11.2024. Kjo është një tarifë që gati dy vitesh nuk aplikohet në bashkinë Patos, është hequr në paketën e vitit 2024 por thjeshtë për shkak të një lapsusi në faqen e fundit të paketës të 2025, të tabela përmbledhëse numër 22, ka ngelur si zë por ajo nuk aplikohet më dhe është thjesht një lapsus.

Armand Ahmetaj- Faleminderit fjalën e ka Lori!

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe ky projektvendim i cili komisioni është shprehur se voton me katër vota pro dhe një kundër.

Ky projektvendim është në përputhje me bazën ligjore.

Erald Çepele – Kam të njejtën pyetje që kanë drejtuar në mbledhjen komisionit sa është efekti financiar si të ardhura të munguara në buxhetin e 2025 se këtu është bërë një përlllogaritje në paketën fiskale dhe kjo do të jetë e ardhur e munguar unë doja të dija vlerën.

Zv/kryetare e bashkisë Ina Sauli - Fillimisht siç e tha dhe Endri gjatë shpjegimit të relacionit ky ka qenë lapsus i cili nuk ka qenë as i reflektuar në tabelën e të ardhurave domethënë tek zërat e të ardhurave nuk ka qenë ekzistues në paketën fiskale ky kishte ngelur si zë pa u hequr si lapsus vetëm tek tabela e fundit domethënë nuk ka asnjë efektet të ardhurat.

Tek paketa fiskale tek zëri i të ardhurave ka qenë çdo gjë në rregull nuk ka qenë e paraqitur fare thjesht në tabelën e fundit ka qenë i vendosur si zë por pa-efekt financiarë kur është miratuar ka kaluar kështu pa u kapur si lapsus më pas kur është bërë tek në një kontroll rastësor është kapur dhe donim ta saktësonim dhe prandaj erdhëm me ndryshim.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 82, datë 27.11.2024 “ Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 12 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Rendolir Shyret



Lori Musej Kap.

ARTAN VELI

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1918/12 Prot.

Patos më 22.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2025 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i kërkesës nr. 1918 prot., datë 23.06.2025 për dhënie ndihmë ekonomike.

Armand Ahmetaj- Kjo këkesë i është deleguar për opinion dv komisioneve. Komisionit të Ekonomisë dhe komisionit per Arsim, Shëndetësi, Kulturë, Rini dhe Sportet, paraprakisht e ka kërkuar fjalën komisioni për Arsim, Shëndetësi, Kulturë, Rini dhe Sporte këshilltarja Albiona Lamaj.

Atëherë rastin në fjalë pasi ne kemi shqyrtuar dokumentacionin kërkesën e zonjës ardhur në këshillin bashkiak nga ana është shëndetësore i plotëson kriteret e rregullores që ne kemi miratuar si anëtarë këshilli zonja në fjalë përveç pjesës shëndetësore ka dhe anën sociale është e divorcuar jeton vetëm dhe kujdeset për babain e moshuar, është operuar para 5-6 vitesh me kancer të gjirit dhe ka një riaktivizim të sëmundjes dhe tani është me metastaza kockore, dhe në mëlçi kështu që kjo ndihma financiare është e nevojshme në rastin e sëmundjes saj dhe plotëson kriteret dhe shëndetësore dhe sociale.

Artan Velçani –Grupi ynë i partisë Socialiste mori në konsideratë edhe këtë pikë të rendit të ditës si gjithë të tjerat e vlerësoi me përgjegjësi në zemërgjerësi dhe solidaritet dhe po ashtu si në rastin e pikës së 7 vlerësoi që t’ja japi ekzekutivit për ta ekzekutuar bile me propozim të anëtarit të këshillit Klaudio Alisininaj është vendosur një vlerë prej 200 mijë lekësh.

Ftoj gjithë anëtarët e këshillit që ta miratojmë.

Albiona- E propozon ekzekutivi.

Armand Ahmetaj- Ekzekutivi do zbatoi vendimin tonë.

Armand Ahmetaj- Atëhere unë propozoi të ta kalojmë në votim pikën 9 ndihmën financiare për znj. Nazerina Resuli me vlerën 200 mijë lekë nga fondi rezervë.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 12 vota pro.

Praktika ligjore për zbardhjen dhe zbatimin e këtij vendimi është përgjegjësi e administratës së bashkisë. I urojmë shërim të shpejtë znj. Nazerina.

Artan Velçani- I nderuar kryetar unë doja të jepja një opinion në emer të grupit të partis PS për gjithë miratimet që ne bëmë sot në këshillin bashkiak, mund ta kisha marrë fjalën edhe gjatë pikave por mendova që në tërësi mbledhjes së sotme u karakterizua nga nevoja për të ardhur në ndihmë banorëve në fatkeqësi për të miratuar gjithashtu projektvendimet e ndihmës ekonomike për të cilat neve e kemi diskutuar gjerësisht të grupit pavarësisht keqardhjes sonë për vleftat e tyre morëm përsipër në mënyrë unanime dhe ftojmë audiencën po edhe ekzekutivin që për gjithë ata persona të cilët nuk futet në skenë për arsye që nuk mund t’i themi këtu që janë objektive të ndihmojmë edhe vetë neve nga ana tjetër për ndihmimet që folëm ishte një shenjë solidariteti që tregon që partia socialiste në përgjithësi grupi jonë është shumë sensibil ndaj njerëzve në nevojë dhe kisha dhe një

vërejtje për rastin e pikës 8 që të jemi shumë përgjegjshëm si ekzekutive dhe këshill për të mos bërë edhe lapsus të tilla që ndodhin i parktikisht dhe të kemi kujdes sepse po vjen fundi vitin ku do të projektohet buxheti i ri dhe niveli taksat e reja.

Erald Çepele- Kam një shqetësim nga qytetarët lidhur me rikonstruksioni e shkollës së Zharrëzës është me cila është miratuar nga edhe pritet të fillojë punimet së shpejti ka si të themi një paqartësi të nxënësit dhe prindërit të cilët do të çojnë fëmijët në shkollë për vitin shkollor i cili fillon shtator çfarë masë janë marrë nga bashkia qoftë ambientin ku do transferohen këta nxënës qoftë dhe për transportin se po ikin nxënësit dhe po transferojnë studimet e tyre në shkollat e Fierit e kanë autobuzin të dera e shtëpis e ndërkohë që nuk është marrë asnjë masë nuk u është thënë asnjë gjë se ku do ti çojnë fëmijët si do ndahet e mesme dhe tetëvjeçarja se shkollë e mesme përgjithshme dhe gjimnazistët, gjimnazistët kanë filluar regjistrimet në Fier dhe rrezikon që të mbyllet klasa e gjimnazit në Njësinë Administrative Zharrëes.

Është një problem emediat, kërkojnë nga ekzekutivi një sqarim edhe më përpara se mbledhja e ardhshme, të merren masa për ambientet ku të transferohen, është gjetur ambient transporti, si do bëhet transporti dhe kur do fillojnë punimet dhe sa do zgjasin, kështu që duhet të merret një fushatë sensibilizuese për të sqaruar prindërit që të mos transferojnë nxënësit në shkollat e qytetit të Fierit rrezikon mbylljen.

Juela Shpata - përshëndetje të gjithëve ne masa tona i kemi marrë do tju japim dhe juve një shpjegim së bashku me drejtoreshën e zyrës Arsimore Vendore për pjesën e transportit nxënësve nga ana jonë si institucion kemi parë disa ambiente për të përshtatur sa më mirë të gjithë fëmijët duke menduar që kopshtin do ta transferojnë përsëri në njërën nga godina tona ose në Verbas ose të kopshtit që është tek ura në Zharrës transporti do të sigurohet nga bashkia për kopshtin. Verbas është objekti i rikonstruktuar është marrë në dorëzim përderisa atje u zhvillua 389/1 gjatë periudhës zgjedhore do të thotë që objektin e kemi marrë dorëzim se nuk bëjmë veprime pa marrë asgjë në dorëzim tjetra është që nga klasa e parë deri në klasën e pestë është diskutuar me drejtoreshën në shkollës dhe me drejtoreshë e zyrës arsimore që fëmijët të jenë afër shkollës ekzistuese pra do të marrim një ambient me qera që është shumë i përshtatshëm me shumë ndriçim me shumë xhama do jetë ndriçim natyral dhe fëmijët janë deri në orën 12 atje ndërsa nga klasa e pestë nga klasa e gjashtë deri në vitin e tretë të gjimnazit do të jenë ambientet e shkollës Koli Dimo në Frashër.

Transporti do të sigurohet si është siguruar gjithmonë për të gjithë fëmijët që ne na vijnë nga të gjimnazit që nga vijnë nga Belina drejtoresha shkollës pjesën e transportit e ka zgjedhur me drejtoreshën e zyrës arsimore vendore dhe është OK. Këtë gjë e kërkuam me patjetër që të ishim në Frashër për të vetmen mundësi që ne mos të na ikin fëmijët dhe ne të gjithë fëmijët maturantë të gjimnazit të Frashërit të Belinës nuk do tna iki asnjë nga këta prandaj ju them që transporti është i siguruar.

Erald Çepele- Por ata po ikin në Fier

Juela Shpata – gjithmonë ka rregjistrime, ne nuk mund ti pengojmë ata.

Vjollca Kasaj – për këtë problem unë do mendoja që mund të bëj edhe një zgjidhje më aktuale siç është vepruar te shkollat e tjera sepse nuk është rikonstruksioni i parë i shkollave që bëhet në Patos kështu është operuar edhe për shkollat e tjera për shembull të bëhet të fillojë rikonstruksioni dy muaj përpara domethënë të filloi njëherë shkolla me qëllim që aty garantoet frekuentimi i shkollës në muajin shtator tetor dhe rikonstruksioni të filloi më pas me këtë sigurohet edhe mos lëvizja e mësuesve dhe nxënësve, kjo është operuar për të gjitha shkollat e Patosit është për të ruajtur kontigjentin e nxënësve dhe të mësuesve atje mos të preken nga lëvizjet e nxënësve sepse duke frekuentuar muajin shtator tetor nxënësit aty e kanë të garantuar që do jenë në vazhdimësi në atë shkollë.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

